



# ANALIZË E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2007

Janar, 2008

Në mbështetje të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “ për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, neni 51, pika 1, ku thuhet që “ *Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 50 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve vendore*”, Këshilli i Qarkut Shkodër, gjithnjë në mbështetje të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, neni 51, pika 8, ku thuhet “ *Në rast se këshilli i qarkut nuk konstituohet deri 90 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore, prefekti ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e këtij këshilli deri në çastin e konstituimit*” mbas zgjedhjeve vendore të 18 shkurtit, ka qënë i shpërndarë dhe të gjitha funksionet dhe kompetencat e tij i ka ushtruar institucioni i prefektit.

Në bazë të shkresës së Ministrisë së Brendshme me nr. Prot. 2000, datë 16.04.2007 “ Mbi organizimin e mbledhjes së parë të Këshillit të Qarkut”, përfaqësuesit e të zgjedhurve vendorë të Qarkut Shkodër, të dalur nga zgjedhjet e 18 shkurtit 2007, të thirrur në mbledhje nga Kryetari i Bashkisë Qendër Qarku z. Lorenc Luka, me datë 06.08.2007, pas verifikimit dhe vërtetimit të mandateve të anëtarëve të këshillit nga komisioni i mandateve, vendosën me unanimitet të plotë Konstituimin e Këshillit të qarkut Shkodër për mandatin e ri 2007.

Këshilli i Qarkut Shkodër, në bazë të ligjit 8652, datë 31.07. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i mbledhur gjithsej 5( pesë herë) që me konstituimin e tij, dt. 06.08.2007 ka ushtruar veprimtarinë e tij **vendimmarrëse** bazuar në:

- Vendimi Nr. 1, i datës 06. 08. 2007

**Për konstituimin e Këshillit të Qarkut Shkodër** (të përbërë nga 65 anëtarë, kryetarë komune a bashkie dhe përfaqësues të këshillit komunal ose bashkiak).

- Vendimi Nr. 2 i datës 06. 08. 2007

**Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Qarkut** (me propozimin e një grupi këshilltarësh dhe miratimit nga pjesëmarrësit në mbledhje, u vendos që z. Gjovalin Kolombi të zgjidhet Kryetar i Këshillit të qarkut Shkodër për mandatin e Ri 2007.

- Vendimi Nr. 3 i datës 06. 08. 2007

**Për zgjedhjen e Nën Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër.** Z. Hajrullah Gjekaj

- Vendimi Nr. 4 i datës 06. 08. 2007

**Për zgjedhjen e Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër**( të përbërë nga Kryetari, Nën Kryetari dhe 9 anëtarë ).

- Vendimi Nr. 6 i datës 20. 08. 2007

**Për Rregulloren e Organizimit dhe funksionimit të K.Q. Shkodër** ( rregullore që u hartua në mbështetje të rregullores së mëparshme të funksionimit të Këshillit të qarkut Shkodër e cila do të zbatohet për të gjithë mandatin katër vjeçar 2007-2011 për dispozita të përgjithshme, konstituimin e këshillit të qarkut, funksionimin e këshillit të qarkut, kryetarin e këshillit të qarkut, kryesinë e këshillit të qarkut, kompetencat e këshillit të qarkut, sekretarinë e këshillit të qarkut, komisionet e këshilltarëve dhe paraqitjen e projekt/vendimeve në këshill.

- Vendimi Nr. 8 i datës 20. 08. 2007

**Mbi krijimin e Komisioneve të Këshillit të Qarkut Shkodër.** ( Krijimin e 13 komisioneve të përherëshme të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe shpërndarjen e këshilltarëve sipas komisioneve të propozuara- Komisioni Financë-Buxhet, Komisioni I Kontrollit, Komisioni Ekonomi, Shërbim, Gjendje Emergjente, Komisioni Shërbimi Urbanistik dhe Rregullimi I Territorit, Komisioni I Bujqësisë, Komisioni I Pronës, Komisioni i Arsim, Kulturë, Rinisë dhe Sporteve, komisioni I Ligjeve, Komisioni I shëndetit Publik, Mbrojtjes dhe Mjedisit, Komisioni I rendit Publik dhe Mbrojtjes, Komisioni I Marrëdhënieve me Jashtë, Komisioni Nxitje Biznesi dhe Komisioni I të Drejtave të njeriut.

- Vendimi Nr. 21 i datës 20. 08. 2007

**Mbi vendosjen e masës së shpërblimit për anëtarët e K.Q. Shkodër për vitin 2007.**

- Vendim Nr. 25 date 27.08.2007

**Mbi zgjedhjen e sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Shkodër**( Me propozim të z. Broz Marku, kryetar I grupit të këshilltarëve të PD dhe me miratimin e pjesëmarrësve në mbledhje, u vendos zgjedhja e Z. Rudolf Rasha, si Sekretar I Përgjithshëm I Këshillit të Qarkut Shkodër, për mandatin e Ri 2007.)

- Vendim Nr. 26 date 27.08.2007

**Për dhënien e titullit “Nderi i Qarkut” për Z. Mohamed El Ēaei.**

Për ushtrimin e *funksioneve të veta, të deleguara dhe të përbashkëta* Këshilli i Qarkut Shkodër, ka miratur sipas projekt-vendimeve të paraqitura nga departamentet, vendimet si më poshtë vijon:

### **Për funksionet e veta:**

- **Vendimi Nr. 5 i datës 20. 08. 2007**

Mbi strukturën Organike të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2007. ( Ndryshimi I strukturës për vitin 2007 ka pasur të veçantë ngritjen brenda strukturës së vet të Njësisë së Prokurimit, kjo në mbështetje të ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 1 dt. 01.07.2000 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ngritjen e zyrës së re IMT ( Inspektoriati I Mbrojtjes së Tokës) si funksion I deleguar I pushtetit qendror , në mbështetje të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “ Për mbrojtjen e tokës bujqësore”. Ky ristrukturim është bërë duke mos ndryshuar numrin e punonjësve në total 35, që ka qënë ekzistues për vitin 2006. Burimet financiare sipas detajimit të Buxhetit për vitin 2007 kanë qënë:

1. Paga nga Buxheti I Shtetit 27 770 mijë lekë, nga të cilat: paga administrate: 20000 mijë lekë dhe paga Këshilltarë 7770 mijë lekë).

- **Vendimi Nr. 7 i datës 20. 08. 2007**

Mbi normativat e përdorimit të karburantit, gomave.

- **Vendimi Nr. 9 i datës 20. 08. 2007**

Për miratimin e Strukturës Organike të Nd. Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale.

- **Vendimi Nr. 15 i datës 20. 08. 2007**

Mbi vendosjen e masës së pagesës së telefonisë celulare për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2007.

- **Vendimi Nr. 16 i datës 20. 08. 2007**

Mbi veprimtarinë Ekonomiko-Financiare të K. Q. Shkodër për vitin 2006.

- **Vendimi Nr. 17 i datës 20. 08. 2007**

Mbi detajimin e Buxhetit të K. Q. Shkodër për vitin 2007.

- **Vendimi Nr. 18 i datës 20. 08. 2007**

Mbi vendosjen e kuotës së anëtarësisë së Komunave, Bashkive të Qarkut Shkodër për vitin 2007.

- **Vendimi Nr. 19 i datës 20. 08. 2007**

Mbi vendosjen e Tarifave të Shërbimit për të tretët në Qarkun e Shkodrës për vitin 2007.

- **Vendimi Nr. 20 i datës 20. 08. 2007**

Mbi miratimin dhe përdorimin e të ardhurave të K. Q. Shkodër për vitin 2007.

- **Vendimi Nr. 21 i datës 20. 08. 2007**

Mbi vendosjen e masës së shpërblimit për anëtarët e K.Q. Shkodër për vitin 2007.

- **Vendim Nr. 27 date 27.08.2007**

Për miratim fondi në lidhje me organizimin e konferencës së Eurogione Adriatica.

- **Vendim Nr. 28 date 15.11.2007**

Mbi organizimin e Konferencës “Zhvillimi i zonës së Dukagjinit”.

- **Vendim Nr. 29 date 15.11.2007**

Mbi ristrukturimin e zyrës së mbledhjeve për komisionet e Këshillit, KRRT së ,dhe KMT Qarkut.

- **Vendim Nr. 33 date 15.11.2007**

Për miratimin e “Rregullores së funksionimit të administratës të K.Q.Shkodër”.

- **Vendim Nr. 34 date 15.11.2007**

Mbi shtesën e trasfertës së pakushtëzuar për efekt të taksës së sheshtë për K.Q.Shkodër për vitin 2007.

- **Vendim Nr. 35 date 15.11.2007**

Mbi disa transferime fondesh të Buxhetit të vitit 2007 të K.Q.Shkodër.

- **Vendim Nr. 36 date 15.11.2007**

Mbi disa transferime fondesh të buxhetit të vitit 2007 për Nd.R.M.Rr.Rurale Shkodër.

- **Vendim Nr. 37 date 15.11.2007**

Për caktimin e zonës informale të fshatit Oblikë e Madhe me sipërfaqe 19.05.ha, në Komunen Ana Malit.

- **Vendim Nr. 38 date 15.11.2007**

Për miratimin e zones informale Shkodra 1 me sipërfaqe 288.07 ha, në Bashkinë Shkodër.

- **Vendim Nr. 39 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonës informale të fshatit Muriqan prej 38.09 ha Komuna Ana Malit

- **Vendim Nr. 40 date 15.11.2007**

Për caktimin e zonës informale Dobraq 1 në Komunën Rrethina me sipërfaqe 125.06 ha.

- **Vendim Nr. 41 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonës informale të fshatit Juban me sipërfaqe 7268 ha, në Komunën Guri i Zi.

- **Vendim Nr. 42 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonës informale Golem të Komunës Rrethina me sipërfaqe 195.65 ha.

- **Vendim Nr. 43 date 15.11.2007**

Për caktimin e zonës informale të fshatit Grudë e Re me sipërfaqe 141.7 ha në Komunën Rrethina.

- **Vendim Nr. 44 date 15.11.2007**

Për caktimin e zones informale të Vau Dejës 1 me sipërfaqe 44.45 ha, në Bashkinë Vau Dejës.

- **Vendim Nr. 45 date 15.11.2007**

Për caktimin e zonës informale të fshatit Shtoj i Ri me sipërfaqe 105.72 ha, në Komunen Rrethina.

- **Vendim Nr. 46 date 15.11.2007**

Për caktimin e zonës informale Bahçallek me sipërfaqe 46.0 ha në Bashkinë Shkodër.

- **Vendim Nr. 47 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonave informale Vau dejës 2 me sipërfaqe 30.5 ha Bashkia Vau Dejës.

- **Vendim Nr. 48 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonës informale te fshatit Rrencë me sip. 56.86 ha ,në Komunën Guri i Zi.

- **Vendim Nr. 49 date 15.11.2007**

Për caktimin e kufirit të zonës informale të fshatit Barbullush me sipërfaqe 99.5 ha, në Komunën e Bushatit.

- **Vendim Nr. 50 date 15.11.2007**

Për shlyerjen e kuotizacionit për pjesëmarrjen në Asamblenë Rajonale të Europës.

- **Vendim Nr. 51 date 15.11.2007**

Për pjesëmarrjen e K.Q.Shkodër si anëtarë me të drejta të plota në Eurorajonin Adriatik

- **Vendim Nr. 52 date 11.12.2007**

Për organizimin e konferencës “për mbjelljen e Vreshtave ne llojin e rrushit Kallmet ne territorin e Qarkut Shkodër”.

- **Vendim Nr. 53 date 11.12.2007**

Për blerjen e 1(një) autoveture për nevoja te Këshillit te Qarkut Shkodër”.

- **Vendim Nr. 54 date 11.12.2007**

Mbi vendosjen e rojeve për ruajtjen e Ndërtesës se Këshillit te Qarkut Shkodër si dhe te Zyrës se Informacionit Turistik ne Shiroke duke filluar nga 1 Janari 2008”.

- **Vendim Nr. 56 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit te zonës informate, të emërtuar Kuç , me sipërfaqe 26 ha, në Komunën Guri i Zi.

- **Vendim Nr. 57 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit te zonës informate, të emërtuar Shkodra 3 , me sipërfaqe 48.31 ha, në Bashkinë Shkodër.

- **Vendim Nr. 58 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit të zonës informate, të emërtuar Curke (Nënshat) , me sipërfaqe 16.7 ha, në Komunën Hajmel

- **Vendim Nr. 56 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit të zonës informate, të emërtuar Kuç , me sipërfaqe 26 ha, në Komunën Guri i Zi.

- **Vendim Nr. 57 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit të zonës informate, të emërtuar Shkodra 3 , me sipërfaqe 48.31 ha, në Bashkinë Shkodër.

- **Vendim Nr. 58 date 11.12.2007**

Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit të zonës informate, të emërtuar Curke (Nënshat) , me sipërfaqe 16.7 ha, në Komunën Hajmel

### **Për funksione të deleguara:**

- **Vendimi Nr. 10 i datës 20. 08. 2007**

Mbi krijimin e KRRT-së së Qarkut Shkodër.

- **Vendimi Nr. 11 i datës 20. 08. 2007**

Për miratimin e Strukturës Normative të KRRT-së së Qarkut Shkodër.

- **Vendimi Nr. 12 i datës 20. 08. 2007**

Mbi krijimin e Këshillit Teknik të KRRT-së së Qarkut Shkodër.

- **Vendimi Nr. 13 i datës 20. 08. 2007**

K. Q. Shkodër të ushtrojë funksionin e planifikimit urban të dhënies së shesheve dhe të lejeve të ndërtimit në territorin e Bashkive dhe të Komunave, nën juridiksionin e Qarkut Shkodër.

- **Vendimi Nr. 14 i datës 20. 08. 2007**

Për shpërblimin e anëtarëve të KRRT-së së Qarkut Shkodër.

- **Vendimi Nr. 22 i datës 20. 08. 2007**

Për krijimin e Komisionit të Ndarjes së Tokës.

- **Vendimi Nr. 23 i datës 20. 08. 2007**

Për miratimin e Komisionit të Ndarjes së Tokës, të Qarkut Shkodër.

- **Vendim Nr. 24 date 27.08.2007**

Mbi miratimin e antareve të Komisionit të ndarjes së Tokës në K.Q. Shkodër

- **Vendim Nr. 32 date 15.11.2007**

Për krijimin e Komisionit të mbrojtjes së tokës në Qark.

- **Vendim Nr. 55 date 11.12.2007**

Për krijimin e Komisionit të shqyrtimit të Kërkesave për pensione të posaçme shtetërore.

- **Vendim Nr. 62 date 11.12.2007**

“Për miratimin e rregullores së Këshillit të Rregullimit të Territorit të Qarkut Shkodër.

### **Për funksionet e përbashkëta:**

- **Vendimi Nr. 18 i datës 20. 08. 2007**

Mbi vendosjen e kuotës së anëtarësisë së Komunave, Bashkive të Qarkut Shkodër për vitin 2007.

Mbështetur në zbatimin korrekt dhe të vazhdueshëm të objektivave të programuara për vitin 2007, Këshilli i Qarkut Shkodër, bëri të mundur plotësimin e tyre me sukses në të Gjithë treguesit e parashikuar

Gjatë vitit 2007, puna e Këshillit të Qarkut, u përqendrua kryesisht në këto drejtime: U morën masa për zhvillimin normal të veprimtarisë së këshillit të qarkut si organ i zgjedhur dhe vendimarrës. Duke respektuar tematikën e hartuar dhe të miratuar nga Kryetari i Këshillit të qarkut, z. Gjovalin Kolombi, Këshilli i Qarkut ka zhvilluar 5 mbledhje dhe ka marrë 62 vendime.

Vlen të theksohet se të gjitha vendimet e nxjerra nga Këshilli i Qarkut kanë qenë plotësisht të mbështetura në ligjet e parlamentit dhe vendimet e udhëzimet e Këshillit të Ministrave, gjë që vërtetohet edhe nga fakti që ato janë konfirmuar në masën 100% nga prefekti i qarkut.

Në bazë të ligjit 8652, datë 31.07.2000, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, ka ushtruar të gjitha kompetecat e tij dhe gjatë vitit 2007 për mirëorganizimin e funksionimit të veprimtarisë së administratës së qarkut, ka nxjerrë këto **urdhëra të brendshëm:**

Urdhër i Brendshëm

Dt .10.01.2007, me nr. 01 prot.

Për dorëzimin brenda ditës te të gjithë ngrohësve me korent ne magazine.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .11.01.2007, me nr. 02 prot.

Për emërimin e Z.Gj.Miruku drejtore e Dep.Ekonomi –Finance.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .18.01.2007, me nr. 03 prot.

- Për dorëzimin e një kompjuteri, Dep. i Shërbimeve sociale ne magazinën e K. Urdhër i Brendshëm

Dt .01 02.2007, me nr. 04 prot.

Për emërimin e Z.M.Bushati drejtor ne Dep e transportit & emergjencave civile prane K.Q.SH.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .08.02.2007, me nr. 05 prot.

Për vënien ne dispozicion te një kompjuteri inspektoreve te Kontrollit te larte te shtetit.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .08.02.2007, me nr. 06 prot.

Për transferimin e Z. B.Zeka nga zyra e SAMT, M.Madhe ne SAMT Shkodër.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .08.02.2007, me nr. 07 prot.

Për Krijimin e komisionit te blerjeve te vogla.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .08.02.2007, me nr. 08 prot.

Për kalimin ne inventar te 2 automjeteve te renda te K.Q.Shkoder ne inventar z.B.Lezha

- Urdhër i Brendshëm

Dt .06.04.2007, me nr. 09 prot.

Për kalimin e Z.H.Gjekaj ne funksionin e Kryetarit te KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .18.04.2007, me nr. 10 prot.

Për rifillimin e procedurave ligjore te pronave ne zonën e Velipojës.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .20.04.2007, me nr. 11 prot.

Për rifillimin e punës ne pozicionin e meparshim te z.F.Tepelia .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .20.04.2007, me nr. 12 prot.

Për rifillimin e punës ne pozicionin e meparshim te z.F.Tepelia .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .20.04.2007, me nr. 13 prot.

Për lirimimin nga detyra e operatorit e Z. Gj.Sheldia me kërkesën e tij. .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .24.04.2007, me nr. 14 prot.

Për lirimimin nga detyra e drejtores Dep i Urbanistikes i Zj. A.Shllaku me kërkesën e saj.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .01.06.2007, me nr. 15 prot.

Për emërimin e Z.K Luka drejtor ne Dep.e Urbanistikes.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .06.06.2007, me nr. 16 prot.

Për lirimimin nga detyra e zedheneses se Zj. I.Pirani me kërkesën e saj .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .26.06.2007, me nr. 17 prot.

Për dhurimin e 2 albumeve Z.Bashkim Bekteshi ne emër te KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .26.06.2007, me nr. 18 prot.

Për emërimin e Z.S.Metani me detyre specialist ne dep e Urbanistikes pranë KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .02.07.2007, me nr. 19 prot.

Për emërimin e Zj.H.Sallaku me detyre operatore ne dep e Sherbimeve pranë KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .02.07.2007, me nr. 20 prot.

Për emërimin e Z.A.Jakova me detyre zedhenes i Kryetarit të KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .05.07.2007, me nr. 21 prot.

Për largimin e zj.F.Kraja nga Dep i Transportit &Emergjencave civile ne Dep.Ekonomi-Finance prane KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .05.07.2007, me nr. 22 prot.

Për emërimin e Z.F.Taflaj me detyre specialist ne Dep i Transportit &Emergjencave civile prane KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .27.07.2007, me nr. 23 prot.

Për emërimin e Z.R.Handraj me detyre specialist prane SAMT ne KQShkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .27.07.2007, me nr. 24 prot.

Lirimin nga detyra te z. B.Zekaj dhe z.Z.Lasku specialista prane SAMT-se.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .08.08.2007, me nr. 25 prot.

Për krijimin e komisionit të përgatitjes së raportit mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare te K.Q.Shkodër per vitin 2006 dhe për miratimin e buxhetit 2007, dhe komisionit të hartimit të projekt-strukturës se administratës dhe projekt rregulloreve të funksionimit të KQ.Shkodër .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .09.08.2007, me nr. 26 prot.

Për krijimin e komisionit te përkohshëm, qe do te merret me organizimin e konferencës së Euroregione Adriatica, qe do te zhvillohet ne Shkodër ne datat 20 dhe 21 shtator 2007

- Urdhër i Brendshëm

Dt .13.08.2007, me nr. 27 prot.

Drejtuar administratës së K.Q.Shkodër për të gjitha shkresat zyrtare të cilat do të dalin nga departamentet përkatëse të jenë konform rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, dhe tipi i shkrimit të jetë standard Times Neë Roman.

- Urdhër i Përbashkët : Kryetari i K.Q.Shkodër dhe Prefekti i Qarkut Shkodër

Dt .15.08.2007, me nr. 478 prot.

Për koordinimin e punës në plotësimin e procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .16.08.2007, me nr. 28 prot.

Për të bërë pagesën e taksës së regjistrimit dhe atë të qarkullimit për vitet 2005,2006,2007 për autoveturën Tip Benz.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .24.08.2007, me nr. 29 prot.

Për krijimin e grupit të punës për hartimin e skicë-idesë për rrugën Shkodër-Shosh-Breg Lumi.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .24.08.2007, me nr. 31 prot.

Rregulla për përpilimin dhe dërgimin e shkresave

- Urdhër i Brendshëm

Dt .30.08.2007, me nr. 32 prot.

Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .30.08.2007, me nr. 33 prot.

Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .30.08.2007, me nr. 34 prot.

Ngritja e njësisë se Prokurimit .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .30.08.2007, me nr. 35 prot.

Për ndalimin e pirjes se duhanit ne ambientet e institucionit.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .03.09.2007, me nr. 36 prot.



Ne lidhje me detyrat dhe punën e Departamenteve të K.Q. Shkoder.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .03.09.2007, me nr. 37 prot.

Ngritja e Komisionit në lidhje me testimin e çmimit të karburantit në treg.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .06.09.2007, me nr. 38 prot.

Ngritja e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së K.Q. Shkodër

- Urdhër i Brendshëm

Dt .11.09.2007, me nr. 39 prot.

Ngritja e komisionit për vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve që janë në inventar të K.Q. Shkodër që kanë nevojë për riparim (viti 2007)

- Urdhër i Brendshëm

Dt .12.09.2007, me nr. 40 prot.

Ngritja e komisionit për organizimin e takimit Euro-Rajonit.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .12.09.2007, me nr. 41 prot.

z.Preke Marku të zhvillojë procedurat e Prokurimeve në NdRMRRSH.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .17.09.2007, me nr. 42 prot.

Lirim nga detyra.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .19.09.2007, me nr. 43 prot.

Për miratimin e planit të shërbimeve (kur e përfitojnë).

- Urdhër i Brendshëm

Dt .19.09.2007, me nr. 44 prot.

Për emërimin e Z.Klaudian Luka, anëtar i Njësisë Prokurimit.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .26.09.2007, me nr. 45 prot.

Për pagimin e shoferëve (2) për orët jashtë kohës normale.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .1.10.2007, me nr. 46 prot.

Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit për të tretët.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .2.10.2007, me nr. 47 prot.

Për krijimin e Komitetit Ad-HOC.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .3.10.2007, me nr. 48 prot.

Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Urdhër i Brendshëm

Dt .3.10.2007, me nr. 49 prot.

Për pagesën e tarifave të telefonave celulare.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .8.10.2007, me nr. 50 prot.

Për emërimin e z.Mensur Bushati Kryetar i Komisionit të Prokurimit për Tenderin me objekt "Blerje Karburanti dhe vaj".

- Urdhër i Brendshëm

Dt .11.10.2007, me nr 51 prot.

Për pagesën e kuotës së antarsisë prej 1000 euro për vitin 2007 në llogari të Eurorajoni Adriatik.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .18.10.2007, me nr. 52 prot.

Për shpërblimin e Z. Shyqyri Selhani nga fondi i veçantë i vitit 2007.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .19.10.2007, me nr. 53 prot.

Për pagesën e telefonit celular brenda fondit prej 4000 lek për z.F.Tepelia .

- Urdhër i Brendshëm

Dt .31.10.2007, me nr. 54 prot.

Për paisjen urgjente me foton e Presidentit (zyra e kryetarit).

- Urdhër i Brendshëm

Dt .07.11.2007, me nr. 55 prot.

Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të ofertave

- Urdhër i Brendshëm

Dt .18.11.2007, me nr. 56 prot.

Për ngritjen e Komitetit AD-HOC

- Urdhër i Brendshëm

Dt .30.11.2007, me nr. ---- prot.

Për emërimin në detyrë të z.B.Zekja, L.Mali, E.Deda.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .04.12.2007, me nr. 57 prot.

Vërejtje për arsye të ardhjes me vonese.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .04.12.2007, me nr. 58 prot.

Nxjerrja jashtë përdorimi.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .04.12.2007, me nr. 59 prot.

Inventari i mjeteve materiale

- 12/12 : 12.12. 2007

Shpërblimet.

- Urdhër i Brendshëm

Dt .04.12.2007, me nr. 60 prot.

Shpërndarja e Kompjuterave

- 3/12: 03.12.2007

Shpërblimi për 10 000 lek çdo punonjës.

Kërkese për shpërblim

- Urdhër i Brendshëm

Dt .04.12.2007, me nr. 61 prot.

Nxjerrja jashtë përdorimi e vules.

---

Në ndjekjen ditore e mujore të detyrave nga çdo departament e specialist të Këshillit të qarkut Shkodër, për vitin 2007, raportimi dhe bërja prezent e problemeve që bëheshin

pengesë për vazhdimin normal të realizmit të detyrave, kanë ndihmuar në marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Më konkretisht duke parë punën dhe veprimtarinë e cdo departamenti, mund të japim më specifikisht si më poshtë:

### **Departamenti Juridik**

Në mbështetje të ligjit 8654, dt. 31.07.2000 për *funksione të vetat* (që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Këshillit të Qarkut (vendimmarrja) dhe veprimtarinë në lidhje me administratën (ekzekutivi), për *funksionet e deleguara* (që kanë të bëjnë me pensionet e posaçme (propozime për vendimmarrje), pezullimet e lejeve të ndërtimit të automjeteve, përfaqësimit në seanca gjyqësore për funksionet e deleguara të Këshillit të Qarkut si KRRT, komisioni i tokës, kadastra etj dhe për *funksionet e përbashkëta* (që kanë të bëjnë me asistencën juridike për njësitë vendore të qarkut):

Ka siguruar ndihmën Juridike për të gjithë veprimtarinë e Këshillit , Kryetarit, Kryesisë dhe Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër .

Ka hartuar dhe sigluar aktet e nxjerra nga Kryetari i K. Qarkut, nga Këshilli i Qarkut , nga Kryesia e Këshillit të Qarkut në zbatim të akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore.

Ka studiuar, përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Qarkut, projekt-akte ligjore dhe nënligjore që janë kompetencë e Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit.

Ka bashkërenduar dhe ndihmuar administratën për përgatitjen e projektvendimeve .

Ka hartuar dhe përgatitur nga pikëpamja juridike kontratat dhe marrëveshjet që lidh Këshilli i Qarkut me persona fizik (emërimet në punë) apo juridik ( kontratat ne rastin e prokurimeve).

Ka drejtuar punën e njohjes së legjislacionit të ri me punonjësit dhe specialistët e tjerë të administratës së Këshillit Qarkut.

Ka ndjekur marrëdhëniet juridike midis Qarkut, Bashkisë, Komunave dhe Prefekturës së Qarkut Shkodër si dhe me pushtetin Qendror.

Ka dhënë konsulencë juridike përfaqësuesve të komunave dhe bashkive të Qarkut tonë dhe shtetasve që kanë nevojë për konsulencë juridike.

Ka siguruar ndihmën juridike për të gjitha shkresat që dalin nga Departamentet e tjera të Këshillit të Qarkut.

Ka përfaqësuar Këshillin e Qarkut Shkodër në bashkëpunim me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës në të gjitha instancat gjyqësore kur ky ishte palë e paditur ose paditës duke ndjekur çështjen me përgjegjësi në të gjitha shkallët e gjyqimit. Çështje gjyqësore të tjera gjatë vitit 2007 nuk ka patur.  
Gjithashtu:

Ka hartuar dokumentacionin ligjor për Prokurimet Publike sipas Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, VKM nr.1 datë 10.1.2007 me anë të pjesëmarrjes në njësinë e prokurimit me cilësinë e Përgjegjës të Njësisë Prokurimit.

Ka hapur dhe plotësuar Dosjet për shpalljen e dëshmorëve të atdheut dhe për marrjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” në mbështetje të ligjit nr 8607 datë 27.04.2000”Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” dhe VKM 151 datë 25.04.2002, të shoqëruara me relacionin projekt vendimin dhe vendimin përkatës.

Ka përgatitur propozimet për pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve që i drejtohen Këshillit të Ministrave, të cilat merren me vendim të Këshillit të Qarkut duke hartuar relacionet, projekt vendimet dhe vendimet përkatëse sipas VKM nr.429 datë 12.9.2002.

Në mbështetje të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 ka përgatitur kërkesën për marrje Titulli “Nderi i Qarkut “ për z.Mohamed El Ęaei Drejtor i Fondacionit Islamik Relief.

Ka përgatitur vendimet e Kryetarit të Qarkut për pezullimin e lejeve të qarkullimit me kërkesën e Komisarariatit të Policisë Rrugore sipas ligjit nr. 8378 datë 22.7/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë , Udhëzimit të përbashkët nr.1128/1 Prot. Datë 05.03.2004 Ministrisë Rendit Publik dhe nr.1616 datë 6.03.2004 i M.P.V dhe Decentralizimit.

### **Departamenti Ekonomi Financë:**

Në mbështetje të ligjit 8654, dt. 31.07.2000 për *funksione të vetat* (që kanë të bëjnë me administratën e Këshillit të Qarkut dhe Nd.Rr rurale), për *funksionet e deleguara*(që kanë të bëjnë me SAMT, KRRT, sekretar deputeti dhe shpenzime varrimi, ka realizuar veprimatrine dhe analizen ekonomiko-financiare të Këshillit të Qarkut, të cilën e ka ushtruar ne keto drejtime kryesore;

- **I - Menaxhimi i fondeve buxhetore per transferten e pakushtezuar**
  - a – Realizimi dhe përdorimi me efektivitet i të ardhurave.
  - b - Realizimi i shpenzimeve ne përputhje me planet buxhetore.
- **II - Analiza analitike e llogarive buxhetore**
  - a - Analiza e llogarive 600, 601,602 dhe 231.
- **III – Menaxhimi i fondeve te transfertes se kushtezuar.**
  - a –Analiza e shpenzimeve dhe te ardhurave te realizuara.
- **IV- Rregjistrimi në Kontabilitet**
  - a - I Aktiveve të Qëndrueshme te Trupëzuara.
  - b - I materialeve dhe i shërbimeve.
  - c – I mjeteve monetare në bankë dhe në arke.
  - d- Inventarizimi i pasurise.

Duke analizuar drejtimet e mësipeme, Këshilli i Qarkut Shkodër pasqyron realizimet si me poshtë.

## **I Menaxhimi i fondeve buxhetore.**

### **a- Realizimi dhe Përdorimi i të Ardhurave.**

Te ardhurat e vitit 2007 paraqiten si me poshtë;

-Te ardhura te trashëguara nga viti 2006	14176 mijë leke
- Te ardhura te realizuara gjatë vitit 2007	10763 “
- Nga këto përdorë gjatë vitit 2007	12231 “
- Te ardhura te mbetura për vitin 2008	12708 “

Sipas Akt-Rakordimit me Degën e Thesarit të vitit 2007 , të ardhurat e realizuara të vitit 2007 janë 10.763 mijë leke ndërsa planifikimi i tyre për këtë vit ishte 12050 mijë leke . Niveli i realizimit të të ardhurave për vitin 2007(duke mos marrë parasysh të ardh. e trashëguara të vitit 2006) është në masën 89.3 %.

Ky nivel i ndarë sipas planifikimit të të ardhurave është si me poshtë :

1. Te Ardhurat e planifikuara **nga Kuota e Qarkut** për vitin 2007 janë 9250 mijë leke,ndërsa janë realizuar në fakt 7071 mijë leke.Ketu vlen të përmendet ndryshimi i procedurave të Degës së Thesarit për vjeljen e Takës së Qarkut si dhe mos angazhimi i Njesive të Qaverisjes Vendore për derdhjen e saj në Thesar,megjithatë njoftimet e vazhdueshme për realizimin e kësaj takse. Realizimi për vitin 2007 është në masën 76.4% .Pjesa tjetër e të ardhurave që i përkasin vitit 2007 do të derdhet në fillim të vitit 2008,pas Akt-Rakordimeve me Degën e Thesarit dhe me Njesitë Vendore.
2. Te ardhurat nga **lejet e ndertimit** ishin planifikuar në masën 2000 mijë leke dhe janë realizuar 1241 mijë leke ose 62 %.
3. Te ardhurat **Dytesore** ishin planifikuar në masën 300 mijë leke dhe janë realizuar 166 mijë leke ose 55.3%.
4. Janë realizuar edhe të ardhura nga projektet në masën 2285 mijë leke.

Totali i të ardhurave të planifikuara për përdorim për vitin 2007 është 26226 mijë leke kurse realizimi i tyre është 24939 mijë leke ose 95 %.

Gjatë vitit 2007 janë bërë rritje autorizimi 12231 mijë leke dhe janë shpenzuar në fakt 9462 mijë leke dhe pikërisht;

Transferuar fonde për Nd.R.Rr.Rurale	6.303 mijë leke
Shpërblim KRRT	386 “
Mallra dhe shërbime	1.142 “
Llog 604 –Transferime	843 “
Investime	788 “

Janë marrë vendime gjatë vitit 2007 ,por që do të ekzekutohen gjatë vitit 2008;

- Botim Albumi në shumën 400 mijë leke.
- Blerje autoveture në shumën 3000 mijë leke.

Shuma e te ardhurave qe mbesin për tu përdorë gjatë vitit 2008 eshte 12708 mije leke .

**a- Realizimi i shpenzimeve buxhetore.**

Gjatë vitit 2007 për Keshillin e Qarkut janë realizuar shpenzimet për transferten e pakushtëzuar dhe te Ardhurat ;

<b>a - Paga Pune</b>	<b>16.986 mije leke,</b>
<b>b - Paga Keshilltaresh</b>	<b>6.800 “</b>
<b>c- Pagine e KRRT-se</b>	<b>386 “</b>
<b>d - Sig.Shoqërore</b>	<b>3.505 “</b>
<b>d - Mallra dhe Shërbime.</b>	<b>4.276 “</b>
<b>e -Investime.</b>	<b>788 “</b>
<b>g -Transferime(Nd. Rr.Rurale dhe Org. te tjera).</b>	<b>-1.043 “</b>
<b>SHUMA:</b>	<b>33787 “</b>

- Shpenzime për paga , paga këshilltaresh dhe sigurime shoqërore janë realizuar ne zbatim te VKM- se nr. 551 date 7.11.2002, VKM -se Nr. 355 datë 14.06.2006, VKM -se Nr. 434 datë 13.07.2007 si dhe niveleve te miratuara me Vendimin e Këshillit te Qarkut Nr. 5 Date 20.08.2007si dhe shtesa e ardhur dhe zbatuar me Vendim këshilli Nr.34 dt 15.11.2007.
- Për realizimin e vlerës ne “Mallra e Shërbime” prej 4.276 mijë leke është vepruar në zbatim të ligjit nr. 6942 date 25.12.84, VKM nr. 70 datë 11.03.85, si dhe të VKM nr. 1 date 10.01.2007”Për miratimin e rregullave te prokurimit publik “ duke plotësuar kërkesat për funksionimin sa me eficient të aparatit të Këshillit të Qarkut.
- Gjatë vitit 2007 janë realizuar investime në shumën 788 mijë leke ku përfshihen investimet per blerje pajisje për zyra nga të ardhurat e planifikuara si dhe likuidimi i situacionit përfundimtar i Nderteses se Zyres se Informacionit Turistik..
- Tek Transferimet janë përfshire fondet e kaluara ne Nd./jen e Rr.Rurale Shkodër, pagesa per Shoq. e te Verberve,per shoqaten e Qarqeve si dhe pagesa per kuoten e antaresise se Qarkut ne Organizma Nderkombetare, te gjitha këto ne zbatim te Vendimeve te Këshillit te Qarkut gjate vitit 2007.

**II - Analiza analitike e llogarive buxhetore.**

Per te analizuar llogarite buxhetore të vitit 2007 , planifikimin e tyre në Grand dhe të Ardhura si dhe faktin e realizimit te tyre paraqesim tabelën e mëposhtme:

**Realizimi dhe planifikimi i shpenzimeve sipas artikujve buxhetor.**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi buxhetor</b>	<b>Plan grandi</b>	<b>Plan të Ardhura</b>	<b>Realizimi</b>	<b>Vlera të mbetura</b>
------------	--------------------------	--------------------	------------------------	------------------	-------------------------

<b>I</b>	<b>Qarku Shkodër-</b>				
1.	Paga gjithsej Art 600	21118	0	16986	4132
2.	Sigurime shoqërore 601	3800	0	3505	295
3.	Shpenz. Operative Art 602	11920	3610	11462	4068
4.	Investime Art 231	2285	2100	789	3596
5.	Studim proj. Art 230	0	7150	0	7150
6.	Trans. Trashëg. Art. 606	88	0	0	88
7.	Fondi rezervë Art 609	2710	0	0	2710
8.	Transferime Art 604	3036	2000	843	4193
	<b>Gjithsej</b>	<b>44957</b>	<b>14860</b>	<b>33585</b>	
<b>II</b>	<b>Të Ardhura viti 2007</b>				
1.	Taksa e Qarkut		9250	7071	
2.	Leje ndërtimi		2000	1241	
3.	Te ardhura dytësore		300	166	
4.	Qera e shitje trualli		500	0	
5.	Sponsorizime(projekte)		0	2285	
	<b>Gjithsej te Ardhura</b>		<b>12050</b>	<b>10763</b>	

Për sa me sipër sqarojmë se;

**Artikulli 600”Paga”** sipas Buxhetit të vitit 2007 është planifikuar 21118 mijë leke .  
Plani i grandit për Art. 600 është përdorur ne masen 16986 ose ne masen 80.4%.

Kjo tepriçë fondi në këtë artikull ka ardhë si rezultat i mungesës se vazhdueshme në organikën e Qarkut.

**Art. 601 Sig. Shoq.** është përdorur në masën 87.6%, duke bërë pagesat e tyre në kohën e duhur çdo muaj .Diferenca në këtë Artikull ka ardhur si rezultat i mungesës ne organike gjate vitit.

**Shpenzimet Operative , Art. 602,** janë realizuar ne masën 74 % nga i cili 96% nga pjesa e Grandit te planifikuar dhe 31.7 % nga te ardhurat e planifikuara për perdorim.Mbajtja e këtyre shpenzimeve është bere sipas planifikimit për çdo nenartikull dhe është bere përdorimi me efikasitet i tyre.

Paraqitja ne forme table e shpenzimeve operative e ndare kjo ne artikuj dhe nënartikuj për Këshillin e Qarkut është si me poshtë:

Nr	Objekti i prokurimeve	Plani	Fakti	Realizimi
		Vjetori	12/Mujori	%
	<b>MALLRA DHE SHERBIME TË TJERA</b>			
1	6020100 Kancelari	390	194	50
2	6020200 Materiale pastrimi e shërbimi	80	80	100
3	6020300 Mat per funks.paisj.zyrave	60	60	100
4	6020500 Blerje dok.	80	77	96.2
5	6020900 Furnizime e materiale te tjera	100	100	100
	<b>Shuma</b>	<b>710</b>	<b>511</b>	<b>72</b>
	<b>MATERIALE E SHERBIME SPECIALE</b>			
2	6021007 Libra dhe publikime	70	64	91.4

	6021099 Të tjera mat dhe sherb speciale	300	300	100
	<b>Shuma</b>	<b>370</b>	<b>364</b>	<b>98.4</b>
	<b>SHERBIME</b>			
1	6022001 Energji elektrike	285	218	76.5
2	6022002 Ujë	45	0	0
3	6022003 Telefon dhe fax	900	638	71
4	6022004 Posta	120	111	92.5
5	6022005 Lende djegëse për ngrohje	20	0	0
6	6022007 komision bankare tjera	20	7	35
7	6022010 Printime publikime	50	34	68
8	6022011 kosto e Trajn.Sem.	40	0	0
9	6022099 Sherbime te tjera	50	8	16
	<b>Shuma</b>	<b>1530</b>	<b>1016</b>	<b>66.4</b>
	<b>SHPENZIME TRANSPORTI</b>			
1	6023100 Karburant dhe vaj	750	567	75.6
2	6023200 Pjese këmbimi rrota + bateri	250	142	57
3	6023300 Sigurac. mjete	700	113	16
4	6023900 Shpenzime transporti	50	50	100
	<b>Shuma</b>	<b>1750</b>	<b>872</b>	<b>50</b>
	<b>MIREMBAJTJE E ZAKONSHME</b>			
1	6025300 Sh. Miremb.ndertese	400	277	69
2	6025400 Shp.mirembj.elekt.hidr.	250	115	46
3	6025600 Sh. Mjete transhp.	300	297	99
4	6025800 Mat zyre e te pergj.	50	6	12
	<b>Shuma</b>	<b>1000</b>	<b>695</b>	<b>69.5</b>
	<b>SHPENZ .QERADHENIE</b>			
1	<b>602..... Qeradhenie</b>	<b>30</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE</b>			
1	6029001 shp. pritje e percj.	390	114	29
2	6029002 Aktivitete sociale	420	39	12
3	6029004 Shp. sigNdert tj.	60	12	20
4	6029005 honorare + Krrt	620	416	67
5	6029006 paga keshilltare	7770	6800	87.5
6	6029099 Te tjera	280	114	41
	<b>Shuma</b>	<b>9540</b>	<b>7495</b>	<b>79.4</b>
	<b>DIETA</b>			
1	6024100 Dieta brenda vendit	500	410	82
2	6024200 Dieta jashte vendi	100	100	100
	<b>Shuma</b>	<b>600</b>	<b>510</b>	<b>85</b>
	<b>TOTALI LLOG 602</b>	<b>15530</b>	<b>11463</b>	<b>75.5</b>

**Ne Art. 231 ,**

Nga të Ardhurat me Vendime Këshilli janë blerë

1. paisje per zyra në shumën 582 mije leke



2. Pagesa e Sit perf per Z.Inf.Turistik 206 mije leke.

### **III – Menaxhimi i fondeve te transfertes se kushtezuar.**

a –Analiza e shpenzimeve dhe te ardhurave te realizuara.

Ne funksionet e deleguara per Qarkun e Shkodres kemi:

- **Kadastra**
- **Sekretari i Deputetit**
- **Komisin Toke**
- **Inspek.mbrojtjes se tokes**
- **Shpenzime varrimi**

Realizimi i i shpenzimeve per **kadastrin** eshte si me poshte:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i shpenz.</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizimi</b>
1	Paga art.600	3952	3567	90.26
2	Sig.shoq. Art.601	923	747	81
3	Shp.Operative	313	176	56.23
	<b>Gjithsej</b>	<b>5188</b>	<b>4490</b>	<b>86.55</b>

Kadastra realizon edhe te ardhura te cilat derdhen te gjitha ne buxhetin e shtetit.Keshtu per vitin 2007 ajo ka realizuar 464700 leke leke te ardhura.

Realizimi i i shpenzimeve per **Sekretarin e Deputetit** eshte si me poshte:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i shpenz.</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizimi</b>
1	Paga art.600	401	401	100
2	Sig.shoq. Art.601	86	86	100
3	Shp.Operative	40	39	100
	<b>Gjithsej</b>	<b>527</b>	<b>526</b>	<b>100</b>

Realizimi i i shpenzimeve per **Komision toke** jane si me poshte:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i shpenz.</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizimi</b>
1	Paga art.600	500	490	98
	<b>Gjithsej</b>	<b>500</b>	<b>490</b>	<b>98</b>

Lidhur me **Inspek.Mbrojtjes se Tokes** fondi i dhene prej 1028 mije leke nuk eshte perdorur per arsye te voneses se ngritjes se kesaj strukture brenda Qarkut.

**Shpenzimet e varrimit** jane realizuar plan – 2699  
Fakt - 2648

### **IV- Rregjistrimi në kontabilitet**

Në Dep. e Ekonomi- Financës janë të mbajtura dhe të regjistruara të gjitha veprimet kontabël gjatë gjithë vitit 2007 në menyrë kronologjike .Veprimet mbahen të regjistruara në librat perketës të kontabilitetit.

Në fund të vitit është bërë inventarizimi i pasurisë së Qarkut si për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara dhe për Inventarin e Imët . Eshte bere nxjerrja jashte perdorimit e disa materialeve nga komisioni i ngritur per kete qellim.

Në mënyre kronologjike çdo ditë bëhet regjistrimi i veprimeve të arkës dhe bankës duke mospatur asnjë diference veprimi.

Evidentimi i veprimeve kontabël bëhet konform ligjit “Për kontabilitetin”si dhe akteve te tjera ligjore dhe vendimeve për kryerjen e veprimeve.

### **Departamenti i Shërbimeve**

Në bazë të ligjit 8654, dt. 31.07.2000, gjatë vitit 2007, ky departament ka ushtruar veprimtarinë e tij sipas detyrave funksionale në fushën e shërbimeve sociale, të investimeve të arsimit dhe shëndetsisë.

#### **A- “Për funksionet e veta”**

Bazuar në ligjin nr 8652 dt 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 7 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” si dhe nenit nr 13 “Funksionet e qarkut”, ligjin nr 8379 dt 29.07.1998 “Për hartimin e zbatimin e buxhetit te shtetit të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr 9645 dt 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, Ligjit nr 8098 dt 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, VKM nr 277 dt 18.06.1997 “Për përfitimet nga staturë i të verbërit”, ndryshuar me VKM nr 549 dt 07.11.2002, Këshilli i Qarkut Shkodër, me Vendimin nr 20 dt 20.08.2007 “Mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të Këshillit të Qarkut për vitin 2007” pika 1- III,

**- Miratoi fondin prej 600 mijë lek për Shoqatën e të verbërve të Qarkut, si më poshtë vijon:**

- 1-Shoqata e të verbërve Shkodër shuma 300 mijë lek
- 2- Shoqata e të verbërve Pukë shuma 150 mijë lek
- 3-Shoqata e të verbërve M.Madhe shuma 150 mijë lek

#### **B- “Për funksionet e deleguara”**

Bazuar në ligjin nr 8652 dt 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 7 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” si dhe nenit nr 13 “Funksionet e qarkut”, Ligjin nr 9355 dt 10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore”, VKM nr 563 dt 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”,

#### **Ne fushën e Shërbimeve Sociale**

- Ka grumbulluar dokumentacionin e nevojshëm ligjor për problemet në fushën e shërbimeve sociale.
- Ka kontaktuar me punonjësit social në Bashki, Komuna, institucione publike rezidenciale të shërbimeve sociale, me qëllim bashkëpunimin.
- Ka organizuar takime pune me përfaqesues të Njësive Vendore të Qarkut Shkoder , të OJF-ve, të institucione publike te arsimit, rendit,qendrave rezidenciale të shërbimeve sociale, për bashkpunim të ndërsjelltë.
- Ka organizuar Seminarin “Njohja me metodologjinë e projekteve konkurruese të Këshillit të Europes per Shërbimet Sociale” me përfaqesues te Njësive Vendore të Qarku Shkoder, të OJF-ve, të institucione publike, qendrave rezidenciale të shërbimeve sociale, në bashkpunim me Qendren për nxitjen e zhvillimit njerzor (HDPC) Tiranë.

- Ka grumbulluar dhe përpunuar evidencen 4-mujore për “Grupet shoqërore në rrisht” të Njësiye Vendore të Qarkut Shkodër. Për mangësi të e problemet e dala nga raportimet gjatë vitit, në bashkupnim me Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shkodër, është organizuar seminari trajnues me dt 13.12.2007 me të gjithë administratorët shoqëror të Njësiye Vendore të Qarkut. Nuk kanë paraqitur këtë evidencë (ose me shumë mangësi) Njësi të Vendore sipas tabelës:

Nr	Rrethi Shkodër	Rrethi Pukë	Rrethi Malësi e Madhe
1	Bashkia Shkodër (me mangësi)	Bashkia Pukë	Bashkia Koplik
2	Komuna Bushat	Komuna Iballe	Komuna Qender
3	“ Mnelë-Vig	“ Qafë-Mali	
4	“ Shllak	“ Blerim	
5	“ Rrethina	“ Qelëz	
6	“ Shalë	“ Fierzë	
7		“ Qerret	

### **C- “Për funksionet e përbashkëta”**

Bazuar në ligjin nr 8652 dt 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 7 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” si dhe neni nr 13 “Funksionet e qarkut”, ligjin nr 8379 dt 29.07.1998 “Për hartimin e zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin e MASH nr 4786 dt 14.07.2006 “Për hartimin e programit të investimeve për periudhën 2007-2009”, Udhëzimin e MASH nr 8403 dt 07.11.2007 “Për kriteret e konkurimit të projekteve për investimet në arsim nga granti konkurrues” pika 1-i,

#### **Në fushen e Arsimi:**

- Ka ndjekur mbylljen e realizimin e investimeve në objektet e arsimit parauniversitar për vitin 2006 në të gjitha Njësi të Vendore të Qarkut të Shkodrës, deri në marrjen në dorëzim nga drejtoritë e shkollave.
- Ka ndjekur shpërndarjen e paisjeve shkollore në objektet e arsimit parauniversitar për vitin 2006 në të gjitha Njësi të Vendore të Qarkut të Shkodrës, deri në marrjen në dorëzim nga drejtoritë e shkollave.
- Ka ndjekur problemet e paraqitura pranë Departamenti nga të gjitha Njësi të Vendore të Qarkut të Shkodrës, për nevojën e ndërhyrjeve emergjente në ambientet e shkollave për vitin 2007.
- Ka ndjekur shpërndarjen e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësi të vendore të qarkut, nga fondi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për Grantet konkurruese duke bërë edhe analizën e nivelit të thithjes së investimeve e koeficientët krahasues ndër vite.
- Ka ndjekur zbatimin e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësi të vendore të qarkut, duke tërhequr periodikisht evidencën e degëve të thesarit në Shkodër, Pukë dhe Malësi të Madhe.
- Ka rifreskuar kartelat e gjendjes fizike të investimeve për 2006, investimet e vitit 2007, dhe nevojën për investime në vitin 2008 në objektet shkollore të të gjitha Njësiye Vendore të Qarkut Shkodër.
- Ka dhënë asistencën dhe informacionin e nevojshëm Njësiye Vendore të Qarkut për përpunimin e dokumentacionit teknik të projekt-preventivave të objekteve

shkollore për paraqitjen e tyre pranë DAR Shkodër, ZA në Pukë e ZA në Malësi të Madhe, për konkurim në Komitetin e Vlerësimit të Projekteve me fonde nga Grantet konkurruese pranë MASH, si në periudhën e konkurimit për vitin 2007 (qershor-gusht) ashtu edhe për projekt-buxhetin e investimeve të vitit 2008 (tetor-nëntor).

- Ka realizuar takime pune me kryetarët e Njësive Vendore dhe titullarët e ADR Shkodër, ZA Pukë dhe ZA Malësi e Madhe për mabarëvajtjen e procesit të relizimit të investimeve dhe prioriteteve për vitin 2008.
- Po paraqesim më poshtë një tabelë përmbledhëse të detajimit dhe realizimit të investimeve nga grantet konkurruese për vitin 2007 në objektet e arsimit parauniversitar për Qarkun e Shkodrës:
  - Nga totali prej 781.131 mijë lek të granteve konkurruese të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës,

a) Qarku Shkodër ka fituar 86.336 mijë lek, 11% te fondit total,

b) Nga 34-njësi vendore të qarkut, kanë përfituar vetëm 8-njësi vendore dhe përkatsisht:

Nr	Njesia Vendore	Emertimi Objektiv	Vlera 000/lek	Faza investimit
<b>A</b>	<b>SHKODRA</b>		<b>76236</b>	
1	Bashkia Shkoder	Rip+palester Sh.9-v "B.Kadia"	15000	realizuar
	Bashkia Shkoder	Su+kolaud Sh.9-v "B.Kadia"	150	realizuar
	Bashkia Shkoder	Rik.Shk.9-vjeçare "I.Qemali"	1305	realizuar
	Bashkia Shkoder	Su+kolaud Sh.9-v "I.Qemali"	13	realizuar
	Bashkia Shkoder	Rik.Shk.9-vjeçare "N.Mjeda"	2508	realizuar
	Bashkia Shkoder	Su+kolaud Sh.9-v "N.Mjeda"	25	realizuar
2	Komuna Mnel-Vig	Ndertim shkolla 9-vjeçare Vig	8624	realizuar
	Komuna Mnel-Vig	Su+kolaud Sh.9-v fsh Vig	80	realizuar
3	Komuna Bushat	Nd.shtes 4-klasa shk.9vj Stajke	8051	realizuar
	Komuna Bushat	Su+kolaud Sh.9-v Stajke	80.5	realizuar
4	Komuna Berdice	Nd.i ri shk.9-vjeçare fsh. Trush	15000	realizuar
	Komuna Berdice	Su+kolaud Sh.9-v Trush	150	realizuar
5	Komuna Velipoje	Nd.i ri shk.9-vjeçare fsh.Velipoj	15000	realizuar
	Komuna Velipoje	Su+kolaud Sh.9-vjeçare Velipoj	150	realizuar
6	Komuna e Rrethinave	Nd.shk.9-vj 12-kl.fsh Shtoj Vjeter	10000	realizuar
	Komuna e Rrethinave	Su+kolSh.9-vj.fsh Shtoj I Vjeter	100	realizuar
7	Bashia Vau-Dejes	6-objekte	3200	realizuar
<b>B</b>	<b>Puke</b>			
1	Bashkia Puke	Rik.Shk.Mesme"S.Sinaj"	<b>15000</b>	
<b>C</b>	<b>Malesi e Madhe</b>		<b>0</b>	nuk ka

				investime
<b>D</b>	<b>Paisje shkollore</b>		<b>0</b>	Nuk ka fonde

Bazuar në ligjin nr 8652 dt 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 7 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” si dhe nenit nr 13 “Funksionet e qarkut”, ligjin nr 8379 dt 29.07.1998 “Për hartimin e zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr 636 dt 30.09.2004, “Për hartimin e politikave të decentralizimit në fushën e kujdesit shëndetsor parësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik”, Udhëzimin e përbashkët i MB, MF, MSH, nr 846 dt 11.05.2006 “Për zbatimin e buxhetit të investimeve të reja dhe rikonstrukcione të infrastrukturës fizike të kujdesit parësor”, VKM nr 857 dt 20.12.2006 “për financimin e shërbimit të Drejtorisë së Kujdesit Shëndetsor Parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetsor”:

#### Në fushën e Shëndetsisë

- Ka ndjekur mbylljen e realizimit e investimeve të vitit 2006 në të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut të Shkodrës, deri në marrjen në dorëzim nga drejtoritë e ambulancave a qëndrave shëndetsore.
- Ka ndjekur problemet e paraqitura pranë Departamentit nga të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut të Shkodrës, për nevojën e ndërhyrjeve emergjente në ambientet shëndetsore për vitin 2007.
- Ka ndjekur shpërndarjen e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, nga fondi i Ministrisë së Shëndetsisë për Grantet konkurruese duke bërë edhe analizën e nivelit të thithjes së investimeve e koeficientët krahasues ndër vite.
- Ka ndjekur zbatimin e investimeve të vitit 2007 në të gjitha njësitë vendore të qarkut, duke tërhequr periodikisht evidencën e degëve të thesarit në Shkodër, Pukë dhe Malësi të Madhe.
- Ka rifreskuar kartelat e gjëndjes fizike, investimeve për 2007, dhe nevojën për investime në vitin 2008 në objektet shëndetsore të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Shkodër.
- Ka dhënë asistencën dhe informacionin e nevojshëm për përpunimin e dokumentacionit teknik të projekt-preventivave të objekteve shëndetsore.
- Ka përpunuar projekt-preventivat e tyre në formë elektronike (scanner-CD, diskete) për paraqitjen pranë Ministrisë së Shëndetsisë për konkurim në Komitetin e Vlerësimit të Projekteve me fonde nga Grantet konkurruese, si dhe pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike Tirane.
- Ka rifreskuar kartelat e gjëndjes fizike, investimeve për 2007, dhe nevojën për investime në vitin 2008 në objektet shëndetsore të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Shkodër.
- Ka realizuar takime pune me kryetarët e Njësitë Vendore dhe titullarët e DSHPQ Shkodër, DSHP Pukë dhe DSHP Malësi e Madhe për mabarëvajtjen e procesit të relizimit të investimeve dhe prioriteteve për vitin 2008.
- Po paraqesim më poshtë një tabelë përmbledhëse të detajimit dhe realizimit të investimeve nga grantet konkurruese për vitin 2007 në objektet e shëndetsisë për Qarkun e Shkodrës:

- Nga totali prej 800.000 mijë lek të granteve konkurruese të Ministrisë së

Shëndetsisë,

- a) Qarku Shkodër, ka përfituar 90.750 mijë lek ose 11,3% të fondit total,

b) Ka përfituar 56.650 mijë lek më shumë se në vitin 2006, ose 2.6 herë më shumë, në 20-njësi vendore dhe përkatsisht:

<b>Nr</b>	<b>Njesia Vendore</b>	<b>Emertimi Objektiv</b>	<b>Vlera 000/lek</b>	<b>Faza investimit</b>
<b>A</b>	<b>Rrethi Shkoder</b>		<b>44205</b>	
1	Bashkia Vau-Dejes	Nd.Amb A1 fshati Gomsiqe	1500	realizuar
	Bashkia Vau-Dejes	Nd.Amb A1 fshati Karme	1500	realizuar
	Bashkia Vau-Dejes	Sup+Kulaud per B.Vau-Dejes	120	realizuar
2	Komuna Velipoje	Nd.Amb A2 fshati Mali Kolaj	1000	realizuar
	Komuna Velipoje	Nd.Amb A1 fshati Baks-Rrjoll	1500	realizuar
	Komuna Velipoje	Nd.Amb A1 fshati Luarze	1500	realizuar
	Komuna Velipoje	Nd.Q.Shend me çati fsh,Plazh	3700	realizuar
	Komuna Velipoje	Sup+Kulau per Kom.Velipoje	250	realizuar
3	Komuna Berdice	Rikon.Q.Sh.fsh.Berdie Madhe	3000	realizuar
	Komuna Berdice	Sup+Kulaud per Kom.Berdice	120	realizuar
4	Komuna Guri I Zi	Ndertim.Q.Sh.T2 fshati Juban	3000	realizuar
	Komuna Guri I Zi	Nd.Amb A1 fshati Ganjolle	1500	realizuar
	Komuna Guri I Zi	Nd.Amb A1 fshati Kuç	1500	realizuar
	Komuna Guri I Zi	Nd.Amb A1 fshati Gatjan	1500	realizuar
	Komuna Guri I Zi	Sup+kolaud Komuna Guri Zi	240	realizuar
5	Komuna Rrethina	Ndert.Q.Sh.T2 fshati Hot I Ri	3000	realizuar
	Komuna Rrethina	Ndertim.Q.Sh.T2 fshati Golem	3000	realizuar
	Komuna Rrethina	Nd.Amb A1 fshati Dobraq I Ri	1500	realizuar
	Komuna Rrethina	Nd.Amb A1 fshati Bardhej	1500	realizuar
	Komuna Rrethina	Sup+kolaud Komuna Rrethina	280	realizuar
6	Komuna Shllak	Nd.Amb A1 fshati Bene	1500	realizuar
	Komuna Shllak	Nd.Amb A1 fshati Shllak	1500	realizuar
	Komuna Shllak	Sup+kolaud Komuna Shllak	120	realizuar
7	Komuna Ana e Malit	Nd.Amb A2 fshati Obot	1000	realizuar
	Komuna Ana e Malit	Nd.Amb A2 fshati Alimetaj	1000	realizuar
	Komuna Ana e Malit	Sup+kolau Komuna Ana Malit	90	realizuar
8	Komuna Bushat	Nd.Amb A1 fshati Kusmaq	1500	realizuar
	Komuna Bushat	Nd.Amb A2 fshati Shkjez	3000	realizuar

	Komuna Bushat	Sup+kolaud Bushat	Komuna	165	realizuar
9	Komuna Hajmel	Ndertim.Q.Sh.T2 Hajmel	fshati	3000	realizuar
	Komuna Hajmel	Sup+kolaud Hajmel	Komuna	120	realizuar
<b>B</b>	<b>PUKE</b>			<b>35200</b>	
1	Bashkia Fushe-Arrez	Rik.Q.Shend.Fushe-Arrez		8500	realizuar
	Bashkia Fushe-Arrez	Ndert.Amb A1 fsh F.Arrez		1500	realizuar
2	Komuna Fierze	Rik.Q.Sh fshtai Arst		3000	realizuar
	Komuna Fierze	Ndert.Amb A1 +çati fsh F.Mezi		2000	realizuar
	Komuna Fierze	Ndert.Amb A1 fsh Aprrip		1500	realizuar
3	Komuna Iballe	Nd. A1+çati fsh Nikaj- Mertur		2000	realizuar
4	Komuna Qafe Mali	Ndert.Amb A2 fsh Lajthize		1000	realizuar
	Komuna Qafe Mali	Rik.Q.Shendet fsh.Qafe Mali		2000	realizuar
5	Komuna Qelez	Rik.Q.Shendet fsh.Qelez		2500	realizuar
	Komuna Qelez	Ndert.Amb A1 fsh Dedaj		1000	realizuar
6	Komuna Gjegjan	Ndert.Amb A1 fsh Dom		1000	realizuar
	Komuna Gjegjan	Rik.pershta shkolla 6 fshatra		3000	realizuar
7	Komuna Qeeret	Ndert.Amb A2 fsh Luf-Plan		1500	realizuar
	Komuna Qeeret	Rikon.Q.Shend fsh Kerdhpule		1500	realizuar
8	Komuna Rrape	Ndert.Amb A1 fsh Bicaj		1500	realizuar
9	Komuna Blerim	Ndert.Amb A2 fsh Qebik		1000	realizuar
	Komuna Blerim	Rikons.Q.Shend fsh Dardhe		700	realizuar
<b>C</b>	<b>Malesi e Madhe</b>			<b>11345</b>	
1	Komuna Qender	Nd Amb A2 fsh Jubice		1000	realizuar
	Komuna Qender	Nd Amb A1 fsh Bogic- Palvar		1500	Bllokuar investimi
	Komuna Qender	Supervi+kulaudator		105	realizuar pjesërisht
2	Komuna Shkrel	Nd Amb A2 fsh Lohe e Siperm		1000	realizuar
	Komuna Shkrel	Riko.Q.Sh+ rrethim fsh Zagore		4000	realizuar
	Komuna Shkrel	Nd Amb A1 +Cati fsh Razem		2000	realizuar
	Komuna Shkrel	Nd Amb A1 fsh Kokpapaj		1500	realizuar
	Komuna Shkrel	Supervi+kulaudator		240	realizuar

**Departamenti i Urbanistikës**

Në bazë të ligjit 8654, dt. 31.07.2000, për *funksione të veta*(që kanë të bëjnë me hartimin e projekteve ndërrajonale urbane), *për funksione të deleguara*(Krijimin e KRRT në Qark nga delegimin e komunave dhe bashkive)dhe për *funksione të përbashkëta*: (asistencën teknike pranë KRRT të njërive vendore të qarkut), gjatë vitit 2007 ka arritur të realizojë veprimtaritë e mëposhtme :

Në funksion të krijimit të hartës së vlerës së tokës për qarkun Shkodër, ka realizuar digjitalizimin e plotë të arshivës teknike të KRRT-së, për periudhen 1991-1998 dhe i është dërguar Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Për rrugën e Dugagjinit ka hartuar relacionin teknik për realizimin e projektit të rrugës. Gjithashtu është në proces hartimi i detyrës së projektimit për realizimin e projektit të rrugës.

Ka shqyrtuar dokumentacionin e njërive vendore lidhur me zonat informale të propozuara, për miratim në Këshillin e Qarkut.

Ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e paraqitur nga Komuna Postrribë, Komuna Dajç, Komuna Bërdicë, Bashkia Shkodër , Komuna Gur i Zi , Bashkia Vau Dejës, Komuna Ana e Malit, Komuna Rrethina, Komuna Hajmel, Komuna Bushat dhe Bashkia Koplík.

Janë hartuar relacionet dhe projekt vendimet për miratimin e 4 zonave informale, të cilat janë miratuar në Kryesinë e Këshillit të Qarkut me datë 02.02.2007 dhe janë;

1. Zona informale Dajç 1, Komuna Dajç.
2. Zona informale Ura e Mesit –Qendër-ish SMT-Ullishte-Ish Pularia , Komuna Postrribë.
3. Zona informale Trush 1, Komuna Bërdicë.
4. Zona informale Bushat 1 , Komuna Bushat.

Ka hartuar p/vendime dhe relacione “Për miratimin e propozimit për caktimin e kufirit të zonave informale “, për 18 zona informale , të cilat janë;

1. Zona informale Shkodra 1, Bashkia Shkodër.
2. Zona informale Shkodra 2, Bashkia Shkodër.
3. Zona informale Shkodra 3, Bashkia Shkodër.
4. Zona informale Bahçallek, Bashkia Shkodër
5. Zona informale Vau Dejës 1, Bashkia Vau Dejës.
6. Zona informale Vau Dejës 2, Bashkia Vau Dejës.
7. Zona informale Rrenc, Komuna Gur i Zi.
8. Zona informale Juban, Komuna Gur i Zi.
9. Zona informale Kuç, Komuna Gur i Zi.
10. Zona informale Oblikë e Madhe, Komuna Ana e Malit.
11. Zona informale Muriqan, Komuna Ana e Malit.
12. Zona informale Golem, Komuna Rrethina.
13. Zona informale Grudë e Re , Komuna Rrethina.
14. Zona informale Shtoj i Ri, Komuna Rrethina.
15. Zona informale Dobraç 1, Komuna Rrethina.
16. Zona informale Hot i Ri, Komuna Rrethina.
17. Zona informale Barbullush, Komuna Bushat.
18. Zona informale (Curke) Nënshat, Komuna Hajmel.

Për mangësi dokumentacioni është pezulluar hartimi i projektve për disa zona të tjera, konkretisht Zona informale Zogaj(zonë turistike),Shirokë(zonë turistike), Koplík 1 (zonë e mbrojtur), Dobraç 2, Shtoj i Vjetër dhe Zusi të cilat ndodhen përkatësisht në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Koplík, dhe në Komunën Rrethina.Është në proces



shqyrtimi dokumentacioni i paraqitur nga Komuna Rrethina për zonën informale Bleran-Bardhaj.

Ka realizuar procedurat ligjore për lidhjen e marrëveshjeve me njësitë vendore , që kanë deleguar në Këshillin e Qarkut Shkodër, funksionin e planifikimit urban , të cilat janë ;

1. Komuna Gur i Zi
2. Komuna Vig-Mnelë
3. Komuna Temal
4. Komuna Shkrel
5. Komuna Kastrat
6. Komuna Qerret
7. Komuna Qendër

Janë në proces lidhja e akt-marrëveshjeve me Komunën Gruemirë dhe Komunën Bërdicë.

Ka shqyrtuar dhe realizuar zgjidhjen ligjore të të gjitha kërkesave dhe shkresave që vijnë në Departamentin e Urbanistikës.

Ka konfirmuar harta pronësie viti 62-81, sipas procedurës përkatëse.

Janë miratuar pranë KRRTRSH-së 3 studime urbanistike bazuar në masterplanin e Velipojës.

Është ndjekur procedura për shpalljen e zonës ekonomike (park industrial) të Koplikut .

Është marre me procedurën për tenderin e Sinjalistikës turistike te Qarkut.

Departamenti i Urbanistikës, në funksion të mirëorganizimit dhe efektivitetit të punës së Këshillit Teknik dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Qarkut Shkodër ka hartuar ;

- Rregulloren e Këshillit Teknik dhe,
- Rregulloren e K.RR.T.-së Qarkut

**Këshilli i Rregullimit të Territorit të Qarkut Shkodër** , në mbledhjet e tij të datave 28.09.2007 dhe 30.11.2007 , ka marrë këto vendime:

- Vendimi nr.1 , miratim leje ndërtimi për “*Sinjalistika turistike e Qarkut Shkodër*”.
- Vendimi nr.2, miratim studim urbanistik për objektin “*Pika e përbashkët e kalimit kufitar Muriqan-Sukobinë*” .
- Vendimi nr.3, Miratim studim urbanistik pjesor dhe leje shësh ndërtimi për objektin “*Antenë AMC në fshatin Sheldi*”, Komuna Guri i Zi.
- Vendimi nr.4, Miratim studim urbanistik pjesor dhe leje shesh ndërtimi për objektin “*Qendër Komunitare , 2 kate*”, në Komunën Gur i Zi.
- Vendimi nr.5, Miratim studim urbanistik dhe leje shesh ndërtimi për objektin “*Ambulancë TIP-T2, në fshatin Juban*”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.6, Miratim studim urbanistik dhe leje shesh ndërtimi për objektin “*Ambulancë TIP-A1, në fshatin Kuç*”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.7, Miratim studim urbanistik dhe leje shesh ndërtimi për objektin “*Ambulancë TIP-A1, në fshatin Gajtan*”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.8, Miratim studim urbanistik dhe leje shesh ndërtimi për objektin “*Ambulancë TIP-A1, në fshatin Ganjollë*”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.1, Miratim leje ndërtimi për objektin “*Antenë AMC në fshatin Sheldi*”, Komuna Guri i Zi.

- Vendimi nr.2, Miratim leje ndërtimi për objektin ”Qendër Komunitare , 2 kate”, në Komunën Gur i Zi.
- Vendimi nr.3, Miratim leje ndërtimi për objektin “Ambulancë TIP-A1, në fshatin Gajtan”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.4, Miratim leje ndërtimi për objektin “Ambulancë TIP-A1, në fshatin Kuç”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.5, Miratim leje ndërtimi për objektin “Ambulancë TIP-T2, në fshatin Juban”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.6, Miratim leje ndërtimi për objektin “Ambulancë TIP-A1, në fshatin Ganjollë”, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.7, rinovim leje shesh ndërtimi dhe miratim leje ndërtimipër Pikë karburanti-BarBufe, investitor PjetërNdoci, Komuna Gur i Zi.
- Vendimi nr.8, Miratim studim urbanistik, leje shesh ndërtimi deh leje ndërtimi për objektin”Antenë AMC në fshatin Koman”, Komuna Temal.
- Vendimi nr.9, Miratim studim urbanistik, leje shesh ndërtimi deh leje ndërtimi për objektin”Antenë AMC në fshatin Mnelë e Madhe”, Komuna Vig-Mnelë.

**SAMT** është vetë funksion i deleguar i qarkut, me ligj organik të veprimtarisë së tij dhe ka funksion të përbashkët Komisionin e Tokës dhe IMT. Gjatë vitit 2007 është realizuar:

- Koordinimi i punëve të zyrës së bashku me ato të Pukës dhe M.Madhe.
- Konfirmimi i të gjitha vertetimeve të pronësisë,Z.R.P.P.,A.K.K.Pronave,zyres Punës,sig.shoqërore e tjerë.
- Konfirmimi i hartave të pronësisë.
- Korespondenca e shkresave me institucione qendrore,Komunave si dhe ankesave të qytetarve.
- Bashkpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë,për organizimin e mbledhjeve të Kom.Tokës.
- Përgaditja e materjaleve për mbledhjen e Komis.Mb.Tokës.
- Përgaditja e materialive për mbledhjen e parë të Komisionit të Mbrojtjes së Tokës.
- Verifikimi dhe pregaditja e dokumentacionit(vertetimi) për bonitetin e tokave për leje ndërtimi.
- Vërtetime pronësie për A.K.Pronave.
- Konfirmim skica dhe harta për A.K.K.P.
- Konfirmim i vertetimeve sipas formularit nr.6
- Përgaditje dhe dërgim të dhëna me zyrat e tokave në Pukë e M.Madhe.
- Korespondenca si dhe përgjigje me Drejtorinë e Menaxhimit Tokave(Ministria Bujqësisë.
- Asistuar në seancat e Gjykatës Shkallës Parë ,të Rrethit Gjyqësore Shkodër me cilësinë e palës tretë dhe të paditur, datën 5,6,7 (dy seanca)8 (dy seanca) 9,12(dy seanca)14,19,16,21 (tre seanca),26(dy seanca),27(tre seanca)**Shënim** : Një kopje e fletë-thirrjes dhe kërkesë –padia e subjekteve,objekt padie,ndodhet në dosjen e S.A.M.T.për Gjykatë.
- Përgatitje për seancat gjyqësore.
- Përgatitja dhe formulimi i shkresave për institucione, Z.R.P.P.-A.K.K.P.-Sig.Shoqërore-Drejtoria Menaxhimit Tokave.

- Paraqitja në Gjykatë të rrethit Shkodër me date 15,21.22.23 dhe 29 për subjekt Myftynia Shkodër.
- Përgatitje për seanca gjyqësore
- Pritje e popullit (për shëbime) asistencë, ndihme ekonomike, sigurime shoqërore, bursë etj.
- Prezantim paraprak në komunën Bushat me IMT-ne, rolin, funksionet dhe detyrat si dhe paraqitjen e kërkesës për bashkërendimin e punës për krijimin dhe plotësimin e RMT.
- Korespondence dokumentacioni dhe takim me ISHMT prane Ministrisë së Bujqësisë , ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.
- Organizimi i mbledhjes së parë të Komisionit të Mbrojtjes Së Tokës për qarkun Shkodër dhe dergimi e vendimit te marre ne këtë mbledhje komunave dhe bashkive.
- Krijimi i Regjistrimit të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore (RMT) për fshatin Barbullush , komuna Bushat.

### **Departamenti i Transportit dhe Emergjencave**

Në bazë të ligjit 8652, dt. 31.07.2000 *për funksione të veta*( Administrimi i Nd.Rr.R, Liçensimi i transportit urban ndërkomunal dhe *për funksione të përbashkëta*(Emergjencia civile), gjatë vitit 2007:

Ka verifikuar në vend fatkeqësitë natyrore të ndodhura nga rënia e zjarreve ,rëshqitjet e dheut etj në disa nga bashkitë dhe komunitat e Qarkut tonë si dhe është dhënë konsulenca për plotësimin e dokumentacionit në bazë të ligjeve e vendimeve në fuqi. Pasi janë plotësuar dokumentat e nevojshme nga ana jonë, janë përcjellë procedurat përkatëse në prefekturë për procedim të mëtejshëm.

Janë aprovuar lejet e transportit të ardhura nga bashkitë dhe komunitat.

I është dhënë liçenca Z. Muharrem Koleci që është person juridik dhe njëkohësisht administrator konkretisht liçenca me Nr. 2 datë 05/03/2007 me afat deri me datën 05/03/2010 për linjën Pukë-Shkodër-Pukë si dhe çertifikatat për automjetet që janë në pronësi të këtij personi me targa PU-1211 A (Benz) me Nr. 4 datë 05/03/2007 deri me datë 05/03/2008 ; PU-1107 A (Fiat) me Nr. 1 datë 05/03/2007 deri me datë 05/03/2008 .

Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale për problemet që i kanë dalë kësaj ndërmarrjeje si dhe për nevojat emergjente që ka pasë kjo ndërmarrje për fonde në periudha të caktuara të vitit.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Shkodër janë miratuar linjat e rregullta të lëvizjes së arsimtarëve dhe nxënësve brenda qarkut tonë.

Gjithashtu është bërë takim dhe bashkëpunim me komunitat për paraqitjen hartografike të rrugëve me përfaqësues të Bankës Botërore, të cilët janë duke studiuar zonat ku do të ndërhyhet për projektin e “ **6400 km Rrugë Komunale-Rurale**„. Në bashkëpunim me

Ndërmarrjen Rurale është bërë vëzhgimi i rrugëve më problematike dhe kemi i kemi marrë mendimet këtyre përfaqësuesve se ku duhet të ndërhyhet, konkretisht në Rrugën Ura Mesit-Breg Lumi Dukagjin si prioritet i yni .

Ky departament, sipas problematikave përkatëse: Emergjenca, Transporti dhe Rrugët rurale :

Ka plotësuar dokumentacionin e shtetasve Mark Pepniku e Gjin Pepniku banor të komunës Shalë, Sokol Memçaj banor i komunës Shkrel, shtetasve Gjergj Tuku, Arben Tuku, Gjon Tuku banor të komunës Hajmel dhe është përcjellë në prefekturë për procedim të mëtejshëm.

Gjithashtu janë kthyer për plotësim dokumentacioni sipas kritereve të përcaktuara nga vendimet në fuqi, procedurat për rrëshqitje dhe e djegie banese në bashkinë Shkodër, Vau-Dejës, si dhe në komunat: Fierzë, Dajç, Qafë-Mali, Gjegjanù, Rrethina etj. Krahas kësaj për ti paraprirë situatave emergjente që mund të krijohen nga stina e dimrit si rezultat i rënies së dëborës dhe bllokimit të zonave malore, janë dërguar shkresa (kujtesë ) me qëllimin që komunat të cilat mbulohe me shumë nga reshjet e dëborës në dimër, të jenë të përgatitura për ti bërë ballë këtyre situatave emergjente.

Gjatë këtij viti është punuar me ligjin e ri e aktet e reja nënligjore që kanë rrjedhur nga ky ligj. Në zbatim të këtij ligji, udhëzimeve të reja dhe shkresave të ardhura nga Ministria e Transporteve është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me bashkitë dhe komunat që janë në juridiksionin e qarkut tonë, në mënyrë që ata të zbatojnë me përpikmëri këto udhëzime. Kjo ka bërë që puna për zbatimin e udhëzimeve të reja të jetë sa më e saktë nga ana e tyre. Është bërë miratimi i linjave të reja për transportin e arsimitarëve të Malësisë së Madhe si dhe kategorizimi i këtyre linjave.

Në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale janë plotësuar fishet e grandeve konkurrese për vitin 2008. Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me ndërmarrjen për mirëmbajtjen e rrugëve dytësore si dhe ato që lidhin komunat me njëra tjetrën, në mënyrë që ato të jenë të zhbllokuara gjatë gjithë kohës dhe për të bërë të mundur kalimin normal të automjeteve të ndryshme. Në bashkëpunim me këtë ndërmarrje është mbajtur kontakt me të për të bërë shpërndarjen e skorjeve në pikat më të rrezikshme të rrugëve malore për parandalimin e situatave në rrugë.

Në bashkëpunim me Departamentin e Urbanistikës dhe Zhvillimit , Drejtorin e rrugëve rurale dhe kryetaret e komunave ku kalon rruga e Dukagjinit mbi gjendjen e rruges Shkoder - Mes – Prekal – Kir – Shosh – Breg i Lumit – Theth në administrim te Qarkut . Kerkesen për hartimin e projektit

Kerkesen për ndërtimn e kësaj rruge në vitin 2009 .

Kërkesen për rehabilitimin në lote te rruges se Dukagjinit

Loti I Mes - Prekal 18 KM

Loti II : Prekal – Mali i Shoshit , 21 km

Loti III : Mal i Shoshit – Ura lotoj , 11 km

Loti i IV : Qender - Breg i Lumit , 4 km

Kërkese dhe argumentimin për heqjen nga inventari i rrugve rurale dhe kalimin ne nationale , të aksit Vermosh - Tamarë - Theth - Breg i lumit - Shosh - Kir - Prekal - Mes .

### **Departamenti i Programim Zhvillimit**

Në bazë të ligjit 8654, dt. 31.07.2000, për *funksione të përbashkëta* (marrëdhëniet me qeverisjen qendrore, qeverisjen lokale, institucione publike e private, të huaja dhe vendase) gjatë vitit 2007 :

Ka realizuar mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit për territorin, si bazë për mundësinë e objektivitetit në realizimin e materialeve të ndryshme strategjike dhe si mundësi e mëtejshme për monitorimin e realizimit të tyre nëpërmjet treguesve të ndryshëm, të vendosur sipas standarteve. Gjithashtu duke e konsideruar shpërndarjen e informacionit mbi territorin si marketing për nxitjen e interesit ndaj tij.

Është bërë rifreskimi i të gjitha të dhënave për qarkun Shkodër dhe është punuar për hedhjen në data baze në format access application, interaktiv të të dhënave që është arritur të mbledhen, megjithëse jemi në stadin vetëm të të dhënave statistikore.

Është punuar për përfundimin e Albumit “Shkodra vlera tingëlluese” Ky është bërë me fondet e Kooperimit zviceran. Albumi synon në paraqitjen e vlerave kulturore, historike dhe natyrore të Qarkut tonë duke bërë të mundur tërheqjen e vëmëndjes në drejtim të atraksioneve të ndryshme që ka ky Qark.

Janë përgatitur materialet për faqen e internetit

Në vazhdim nga viti 2006 në bashkëpunim me METE është punuar për dhenien e mendimeve mbi SNZHR ( procesi ka filluar që në vitin 2005 )

- Është marrë pjesë në disa takime, ndërmjet përfaqësuesve të Qarqeve dhe METE
- Është marrë pjesë në takimin ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë, Qarqeve dhe donatoreve
- Është përpunuar materiali me mendimet përfundimtare mbi këtë draft
- Është diskutuar me PNUD mbi konsiderimin e Qarkut Shkodër (së bashku me disa qarqe të tjera të veriut) si qark pilot për realizimin e kësaj strategjie.

Gjatë periudhës Gusht – Dhjetor 2007 është bërë materiali për Rrugën e Dukagjinit. Për këtë është ngritur një grup pune me bazë të gjërë, është mbledhur dhe përpunuar informacion dhe ka lindur ideja më e zgjeruar për hartimin e një strategjie për zhvillimin e zonës së Dukagjinit që do të përfundojë me organizimin e një konference

promovuese. Platforma e punës është ndërtuar, ku jepen referenca dhe ide mbi hartimin e kësaj strategjie.

Nëpërmjet “Programit për zhvillimin lokal dhe decentralizimin”, financuar nga kooperimi zviceran po bëhet i mundur realizimi i programeve të zhvillimit në 7 njësi të qeverisjes vendore.

Ndjekja dhe partneriteti në projekte që aplikohen në territorin e Qarkut tonë, është konsideruar si një nga pikat kryesore e cila bën të mundur realizimin e disa objektivave të zhvillimit në fusha të ndryshme. Në këtë kontekst:

Është bashkëpunuar ne projektin “Hyrje ne metodologjinë për Promovimin, analizën dhe Komunikimin e territorit te Evropës Juglindore”, ku ne jemi partner përfitues. Është nënshkruar edhe një akt marrëveshje për aktivitetet qe do mbuloje Qarku dhe çfare ai do te përfitoje.

Faqe internet e Qarkut brënda së cilës do të inkludohet dhe sistemi GIS për informacionin e pregaditur nga projekti Urbalk dhe gjithashtu GIS për bizneset e Shkodrës fillimisht.

Është vazhduar aktiviteti dhe është bërë koordinimi i njësive vendore te angazhuara në projektin “Programi për zhvillimin lokal dhe decentralizimin”, financuar nga kooperimi zviceran dhe implementuar nga InterCooperation. 8 njësi te nivelit të parë të Pushtetit vendor marrin asistencë për administrimin e pushtetit ne kuadër te decentralizimit dhe te rritjes se kompetencave lokale.

Ky projekt konsiston ne rritjen e cilësisë se shërbimeve dhe ka edhe projekte te fillimit te shpejte (investime deri ne 30000 euro për çdo njësi lokale)

1. Janë zhvilluar tre takime te Komitet Koordinues lokale
2. Janë bere analiza për çdo njësi vendore
3. Janë nxjerre nevojat e ndërhyrjes për çdo njësi vendore
4. Është pregaditur dhe kryer procedura për “Projektet e fillimit te shpejte”
5. Është zhvilluar një takim tek prefekti date 16.10.2007 për problemin e Gurit te Zi ( 27 . 09.2007 )
6. Eshte zhvilluar takimi per Planifikimin Vjetor për vitin 2008 ( 27. 11.2007)

Për piken 4, roli i Qarkut ka qënë se ka marre pjesë në vlerësimin e projekteve të paraqitura. Vlerësimi është bërë sipas kriterëve të parashikuara nga IC.

Ne konkurrim kanë marrë pjesë 4 nga 8 njësite vendore pjesëmarrëse në projekt, Puka, Fushë Arrzi, Dajçi dhe Guri i Zi.

Secila njësi ka përfituar nga një fond prej 30000 Euro. Konkurrimi është bërë për një fond bonus. Qëllimi i këtij fondi ka qenë që të jepet një stimul për njësinë që ka zbatuar rregullat dhe kriteret e kërkuara në mënyre më të sakte, duke patur parasysh se gjatë gjithë punës ka pasur edhe asistencë dhe trajnime për administratat e njërive lokale në fusha të ndryshme.

Përfundimisht kanë dalë me pikë të barabarta Dajçi dhe Fushë Arrzi, dhe u vendos ti ndahet bonusi të dy njërive nga 10000 Euro.

Projektet ishin:

Dajçi – Ndërtim rruge

Guri i Zi – Qendër shëndetësore

Puka – Ndriçim rruge

Fushë Arrzi – Pastrimi i qytetit

Për Gurin e Zi është bërë mbas disa ditësh një ndryshim në destinacion, sepse u akorduan nga burime të tjera fondi për ndërtimin e qendrës shëndetësore. Me kërkesën e vetë njësisë vendore u vendos që të ndërhyhet në ndërtimin e hartës së përdorimit të tokës

Projekti URbalk. "Ndërhyrje për promovimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe të partneritetit ndërkombëtar, në nivel rajonal e lokal". Institucioni "Centro Nord Sud", komuna e Piza, Itali. (lead partner) dhe komuna Smederevo, Serbi

Perfituar:

1. Hartimi i Hartave digjitale tematike
2. Pajisje teknike për Departamentin e Urbanistikës (Informacion me i detajuar gjëndet pranë këtij Departamenti)
3. Vizite studimore në Pisa.

Është punuar si bashkëpunëtor me GTZ në dy projektet e saj në territor: "Planifikimi hapësinor ndërkufitar i rajonit të liqenit të Shkodrës" "Zhvillimi ekonomik dhe nxitja e punësimit në veriun e Shqipërisë."

Është bashkëpunuar në projektin cross border të Bankës Botërore "Menaxhimi i integruar i ekosistemit të Liqenit të Shkodrës"

Jemi ne fazën e zbatimit të kontratave për vazhdimin e procedurave te dy projekteve INTERREG ku jemi te inkuadruar me fonde CARDS-PHARE, ne një tjetër projekt INTERREG A- Italia, ku jemi vetëm përfitues nga fonde te lead partnereve italiane.

#### Projekti NEPTUNE

Mbi promovimin e integruar te territorit (Qarku nuk perfiton fonde por ka vetem perfitime nga partneret italiane.)

Ne kete kuader eshte kryer dhe nje vizite pune ne Ankona, Itali.

#### Projekti ROSA

“Realizimi i një rrjeti mes organizmave të zhvillimit lokal dhe te enteve te panaireve te Adriatikut”

Ideja ishte qe me anë te realizimit te këtij projekti të mundësohej njohja e mëtejshme e territorit te Qarkut nëpërmjet futjes edhe te institucionit tone në një rrjet i cili promovon dhe përmirëson marketingun mbi territor. Kjo duke pasur parasysh se ne projekt janë shume partnere italiane me përvoja të konsolidura në fushën përkatëse dhe gjithashtu dhe partnere nga Ballkani.

Roli i qarkut ne këtë projekt është:

- Pjesëmarrja në Komitetin Drejtues dhe ne tavolinën teknike ( te dy këto pjesëmarrje janë te parashikuara ne buxhet)
- Ne Komitetin Drejtues bëhen propozime për tu marre ne konsiderate për rajonin tone ( ndryshime ne destinacion te veprimtarive psh)
- Analize për territorin tone ne baze te objektivave te projektit
- Paraqitja e tyre ne dokumentet përfundimtare
- Kërkime ne fushën e temes se projektit
- Hyrja ne netëorkun e Adriatikut

#### Projekti ËET Sys B

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i një skenari që përmbledh rregullat për mbikëqyrjen e gjendjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Një aktivitet i rëndesishem do konsistojë në ndërtimin e “një ambienti të përbashkët të informatizuar” që konsiston të ndajë në kohë reale kontributet e njësive te ndryshme deri ne përcaktimin e një sistemi territorial te informatizuar qe do te behet instrumenti kryesor për grupet e punës ndërkufitare në metodologjinë e punës dhe për te rejat teknologjike. Vëmendje e veçante do ti kushtohet menaxhimit te “avancuar” të



informacionit, qe do të thotë zhvillimi me një sistem territorial të integruar për rikualifikimin ekologjik sipas një tematike ambientale jejarqike. (Për komunat e Pulias dhe bashkinë Shkodër.

Eshtë punuar për përgatitjen e projekteve që do të paraqiteshin në takimin e Komisioneve të Eurorajonit Adriatik.

U mor pjese në këtë takim, Venecia Dhjetor 2007, ku dhe u bë paraqitja e këtyre projekteve. Në këtë takim u vlerësuan pozitivisht projektet në vetvete por duke qënë në kontekst lokal kërkonin shtrirje ndërkufitare gjeografike.

U përgatit dhe u zhvillua dita e informimit mbi projektet ndërkufitare nëpërmjet instrumentit IPA të BE në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian.

Te dhëna për fishet e projekteve për grandet konkurruese.

Veprimtaria e organizmave të ndryshëm, vendas dhe të huaj, në territorin e Qarkut tonë është konsideruar si një nga faktorët e rëndësishëm për realizimin e disa objektivave dhe veprimtarive. Kështu: janë mbajtur kontaktet me shume NGO për veprimtaritë e tyre ne qarkun tonë, janë bere takime pune me CAFOD, OXFAM, ADA, SDC, MADA, TEULEDA, SNV, etj organizma e donatore për te ballafaquar prioritetet tona me veprimtarinë e tyre. Kjo me qellim qe ndërhyrjet e tyre te bëhen ne vendin dhe kohen e duhur dhe gjithashtu te mënjanoen mbivendosjet e veprimtarive te tyre, është marrë pjesë në seminarin “Përpunimi i strategjive lokale për Evropën Juglindore, Stip, Maqedoni, udhëtim pune në Rumani, Maqedoni. Konsistoi në shkëmbim eksperience mbi funksionimin e Pushtetit Lokal në përgjithësi dhe strukturave të Zhvillimit Lokal në veçanti.

### **Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit**

Në bazë të ligjit 8652, dt. 31.07.2000, për *funksi*one të vetat (Menaxhimin e burimeve njerëzore e materiale të administratës së këshillit të Qarkut, Vlerësimin sipas ligjit 8549, dt. 11.11.99 “ statusi i nëpunësit civil”, Përgjegjësinë e grumbullimit të deklarimit të pasurisë së nëpunësve të lartë, Vendimarrjen për strukturën, normativat vjetore,

inventarizimin e pasurisë dhe për *funksi*one të deleguara (Grumbullimin e deklarimit të pasurisë së kryetarëve të komunave të qarkut), gjatë vitit 2007 :

Ka hartuar politikën e burimeve njerëzore të institucionit.

Ka planifikuar dhe detajuar numrin e punonjësve të miratuar për institucionin e Këshillit të Qarkut.

Ka shqyrtuar, analizuar dhe ndjekur kriteret e pranimit të specialistëve në aparatit të Këshillit të Qarkut, në përputhje me kërkesat e secilit vend pune, lloji i specialitetit, eksperiencës dhe vjetërsisë në punë, niveli i arsimimit, etj, në përputhje me kriteret e ligjit dhe të akteve nënligjore për statusin e nëpunësit civil.

Ka përgatitur, ndjekur dhe verifikuar rregullat e përgjithshme të veprimtarisë së punonjësve të Aparatit, të kriterëve për zbatimin e disiplinës në punë.

Ka organizuar dhe kryer shërbimin e aparatit për redaktimin e drejtshkrimin e të gjitha materialeve që përgatisin drejtoritë me destinacion në organet e larta shtetërore e institucione të ndryshme.

Ka hartuar planifikimin e fondeve për shpenzimet buxhetore të aparatit të Këshillit të Qarkut, dhe në bazë të planit të buxhetit të miratuar, ndjek dhe evidenton realizimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore.

Ka organizuar, ndjekur dhe administruar shërbimin e autoveturave për të mbuluar nevojat e institucionit, sektorëve dhe punonjësve.

Ka ndjekur realizimin e shpenzimeve dhe organizimin e riparimit e automjeteve.

Ka siguruar bazën materiale për administratën e K. Q. Shkodër me kancelari dhe pajisje të ndryshme. Ka organizuar dhe kryer furnizimin materialo – teknik të aparatit të Këshillit.

Ka përgatitur dhe plotësuar dokumentacionin për inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Ka ruajtur dhe administruar dosjet e personelit të Aparatit të Këshillit të Qarkut.

Ka shumëfishuar materialet për mbledhje Kryesie dhe Këshilli.

Ka hartuar normativat për karburantin, vajin, gomat, etj.

Ka mbikëqyrur magazinën.

Ka mirëmbajtur dhe administruar mjetet materiale të aparatit.

Ka marrë pjesë në organizimin, furnizimin me materiale dhe përgatitjen e dhuratave të Konferencës së Euro – Rajonit Adriatik e mbajtur më 20 – 21 shtator 2007.

Ka siguruar dy vulat e reja të Sekretarisë së Këshillit të Qarkut.

Ka publikuar dhe ka organizuar konkursin e vendeve të lira të punës përkatësisht të zyrës së re të hapur IMT si dhe të inxhinierit të Departamentit të Urbanistikës.

Ka marre pjesë në komisionin e konkursit të vendeve të lira të punës, në korigjimin dhe në shpalljen e fituesve.

Këshilli i Qarkut Shkodër, në zbatim të politikave për zhvillimin ekonomik lokal dhe atë rajonal, i ka kushtuar një rëndësi të vecantë bashkëpunimit me organizma te huaj qe operojnë në qarkun tone, rajoneve fshinje dhe institucioneve ndërkombëtare

Gjatë vitit 2007, Këshilli i Qarkut Shkodër në kuadër të krijimit dhe forcimit të marrëdhënieve me jashtë, është nisur nga parimi i fqinjësisë së mirë me të gjithë vendet e rajonit duke ju përmbajtur orientimeve të një rajoni të stabilizuar ku të gjithë janë të ndërgjegjshëm se vetëm bashkëpunimi ndër rajonal është parakusht për integrim. Këto mesazhe bashkëpunimi përcillen dhe nga organizmat Rajonale të Evropës ku ne aderojmë si vend anëtar.

Në themel të këtij vizioni të ri shihet qartë se ndërtimi i marrëdhënieve ndër rajonale në funksion të politikave të përbashkëta të bashkëpunimit e mirëkuptimit mbetet si qellim për të konsoliduar paqen, stabilitetin dhe prosperitetin. Kjo shihet qartë në bashkëpunimet tona gjithmonë në funksion të paqes dhe zhvillimit. Konkretisht jemi një nga nënshkruesit për të dhëne mbështetjen për ndërtimin e *Parkut Ndërkombëtar të Paqes (në bjeshkët e Nemuna në zonën në mes të Kelmendit dhe Plavë Gucisë)* e ndihmuar dhe e përkrahur në të dy anët e kufirit nga **SNV**, Fondacion Zhvillimi Holandez. Në të ardhmen ky Park ndërkombëtar do të përfshije dhe hapësira të tjera territoriale zhvillimi e bashkëpunimi si në Pejë e zonat përreth saj.

Bashkëpunimi me agjenci të specializuara perëndimore si **ADA austriake**, **GTZ gjermane** **InterCooperation zvicerane**, për të ndërtuar një strategji që ka në thelb përcaktimin e prioriteteve në rritjen e standardit të jetës së qytetarëve të qarkut, luan rrol të rëndësishëm sepse edhe ky është një nga kushtet për integrim, pasi siç dihet tashme së shpejti do fillojë implementimin strategjia ndër sektoriale e zhvillimit rajonal ku qarku Shkoder ai i Lezhës dhe i Dibrës do krijojnë rajonin pilot të zhvillimit dhe kjo përkon dhe me terrenin tashmë të konsoliduar të bashkëpunimit ndërkufitar në këtë zonë dhe me politikën e qeverisë shqiptare.

Nga sa me sipër si Këshill Qarku kemi vlerësuar gjithnjë frymën e dialogut të pastër e transparent me të gjithë faktorët rajonale duke synuar promovimin e imazhit të një Shqipërie, faktor stabiliteti e paqeje. Kjo u demonstrua qartë kur ne, në muajin shtator organizuam në Shkodër *Asamblenë e tretë të Euro Rajonit Adriatik*, (ku aderojnë të gjitha qarqet e shtatë vendeve që lagen nga deti Adriatik), i pari aktivitet ndërkombëtar i këtij lloji në Shkodër.

Kjo mbledhje forcoi marrëdhëniet në mes partnereve duke ofruar një besim të ri në mes nesh, e me vonë në mbledhjen e radhës në Venecia në muajin dhjetor u vendos për bashkëpunim në hartimin e projekteve të cilat janë në interes të gjithë kësaj zone të rëndësishme të Evropës.

Po ashtu kemi përcjellë vazhdimisht mesazhe në përfaqësitë diplomatike evropiane të akredituara në vendin tonë me të cilat kemi patur kontakte, mesazhe të cilat kanë patur si qellim integrimin rajonal duke gjeneruar energji të përbashkëta për krijimin e rrjeteve të ndërlidhura të bashkëpunimit.

Siç thamë dhe me sipër zhvillimi i marrëdhënieve tona me partneret e huaj bazohet në parime të shëndosha, si dialog, korrektësi dhe transparence, për të shtrirë sa më tej fushat e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, sikurse me *Regione Lombardia, Regione Toscana, Regione Emilia Romagna, Regione Marche, Provincia e Forlì Cesena, Comuna e Modenas (Itali)* etj., nëpërmjet projekteve që tashmë janë proces dhe atyre që do na ndjekin në të ardhmen e që do të konkretizohen për të bërë më të stabilizuar zhvillimin

ekonomik të qarkut drejt një të ardhmeje të përbashkët të gjithë vendit drejt integritit evropian.